



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

NJOFTIM PËR APLIKIM

**PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS
SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË**

Të nderuar kolegë/e,

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, mbështetur në ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”, pikës 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 28.02.2019, Urdhrit nr. 413, datë 26.07.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatave për nxënësit në diasporë”, VKM-së nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) **shpall njoftimin: Aplikim për t’u regjistruar në regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.**

1. Mësuesit e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë (kandidatët) të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, duhet të aplikojnë për t’u regjistruar dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar sipas afateve të përcaktuara në këtë njoftim.

2. Afati i aplikimit është nga data 1 – 31 tetor 2020.

3. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u regjistruar në regjistrin shtetëror të mësuesve:

- a) Të jenë diplomuar në fushën e mësuesisë në institucionet e arsimit të lartë. Përparësi kanë mësuesit e diplomuar në degët gjuhë shqipe dhe letërsi, parashkollor, arsim fillor, histori, gjeografi, etnologji, muzikë dhe arte të kulturës shqiptare.
- b) Të jenë licencuar si mësues, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës apo vendeve ku zhvillohet program i mësimi të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
- c) Të jenë pranuar si mësues i mësimi të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në vendet respektive.

4. Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët:

- a) Kërkesë për aplikim sipas shtojcës 1 bashkëlidhur
- b) Curriculum vitae me fotografi sipas formatit EUROPASS, shoqëruar me

dokumentacionin që shoqëron të dhënat në CV.

- c) Kopje e një dokumenti identifikimi: pasaportë apo kartë identiteti.
- d) Kopje e diplomës, në fushën e mësuesisë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (bachelor dhe master ose e integruar).
- e) Kopje e listës së notave, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
- f) Kopje e licencës së mësuesisë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (nëse disponon një të tillë).
- g) Kopje të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara të certifikatave dhe të kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose në vende të tjera.
- h) Dokument që vërteton që kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (të saktësohet nëse është institucion publik apo privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme).

5. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet:

1. Në adresën postare: ASCAP, Rruga Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë,
2. Në adresën e-mailit (sekretaria@ascap.edu.al)

Shënim: Dokumentacioni i pikës 4/d.e.f.g.h duhet të dorëzohet i noterizuar dhe (i përkthyer në gjuhën shqipe për ato të cilët e kanë në gjuhë të huaj)

Ju Faleminderit,

SIHTOJCË 1: Model kërkesë për kandidatët**KËRKESË APLIKIMI**

Drejtuar: Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP),

Tiranë

Unë i nënshkruari _____ kërkoj të jem pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjubës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë. Më poshtë janë të dhënat e mia personale. Më baji përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e këtyre të dhënave.

EMËR, ATËSI, MBIEMËR	
ADRESA:	
TELEFON:	
EMAIL:	
NUMRI PERSONAL I IDENTIFIKIMIT:	
VENDLINDJA:	
VENDBANIMI:	
DIPLOMIMI	
Vendi ku jeni diplomuar:	
Emërtimi i institucionit të lartë ku jeni diplomuar:	
Lloji i institucionit ku jeni diplomuar (publik/privat):	
Lloji i diplomës (Bachelor/master/ diplomë e integruar etj.):	
Fusha ku jeni diplomuar (emërtimi i diplomës) dhe viti i diplomimit:	
Lloji i kualifikimit në mësuesi, në vendbanimin ku ushtroni detyrën e mësuesit:	
VITET E PUNËS	
Vite pune në mësuesi në vendbanimin tuaj me siguracion të rregullt:	
Vite pune në mësuesi në vende të tjera me siguracion të rregullt:	
Jeni diplomuar si mësues në Shqipëri (po ose jo):	
Lloji i diplomës në mësuesi në Shqipëri (emërtimi i diplomës):	
Viti kur jeni diplomuar si mësues në Shqipëri:	
Vite pune në mësuesi në Shqipëri me siguracion të rregullt:	
Kategoria e kualifikimit nëse keni marrë një të tillë në Shqipëri:	
Emërtimi i institucionit ku jepni mësim:	

Lloji i institucionit ku punoni (publik/privat):	
Institucioni ku punoni është në varësi të shtetit ku banoni (po/jo):	
Institucioni ku punoni është në varësi të shtetit shqiptar (po/jo):	
Punoni me kohë të plotë (po/jo):	
Punoni me kohë të pjesshme (po/jo):	

Bashkëlidhur janë dokumentet:

- Curriculum vitae me fotografi sipas formatit EUROPASS.
- Kopje e një dokumenti identifikimi: pasaportë, apo kartë identiteti.
- Kopje e diplomës, në fushën e mësuesisë, tëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (bachelor dhe master ose e integruar).
- Kopje e listës së notave, e përkthyer në në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
- Kopje e licensës së mësuesisë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (nëse disponon një të tillë).
- Kopje të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara të certifikatave dhe të kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose në vende të tjera.
- Dokument që vërteton që kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (të saktësohet nëse është institucion publik ose privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme).